

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ANONIME
"Albsig Jetë" SH.A.**



Sot më datë 02 Gusht 2019 (*dymijë e nëntëmbëdhjetë*), ditën e premte para meje Noterit **SOKOL SH. MALAJ**, Noter në Degën Vendore të Noterisë Tiranë me seli në Rr."L.Gurakuqi", Pallat i ri, u paraqit personalisht:

Z.MUHARREM BARDHOCI i biri i Riza dhe Kadime, lindur në Mamëz, Kukës, më 07.07.1960, banues në Tiranë, Rr. "A.Lenja" Nr 7, i identifikuar me Kartën e Idenditetit #030236066# me Nr personal #G00707039R# aktualisht përdorues i telefonit 00355692045124 **Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë e sigurimeve "ALBSIG" SHA**, regjistruar si Person Juridik, me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me Nr. 30756, datë 09.01.2004, i pajisur me **NIPT K42108801C**, me seli në Rr. "Barrikadave", Tiranë, njëkohësisht edhe si përfaqësues ligjor i Shoqërisë Albsig sh.a, sipas vendimit të përfaqësimit të lëshuar nga Asambleja e Aksionerëve të Albsig sh.a Vendim01/3 të datës 27/06/2019.—

dhe, në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14 prill 2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ka vendosur të krijojë një shoqëri anonime me oferte private të emërtuar "Albsig Jetë" Sh.a., (këtej e tutje referuar edhe si "*Shoqëria*") duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e saj i cili formon pjesë përbërëse të këtij Statuti.

**Neni 1
Emërtimi i Shoqërisë**

Është themeluar një shoqëri anonime, me emërtimin "Albsig Jetë" sh.a.

**Neni 2
Selia**

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga e Barrikadave, Albsig HQ, 1001, Tiranë, Shqipëri.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është e pakufizuar.

**Neni 4
Objekti**

4.1.1 Objekti i Shoqërisë është ofrimi dhe kryerja e aktiviteteve të sigurimit të jetës në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e sigurimeve në Shqipëri si dhe veprimtari të tjera të lejuara nga legjislacioni në fuqi.

4.2 Për qëllimin e realizimit të objektit të mësipërm, Shoqëria mund edhe:

- (a) të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm që lidhet me pasuri të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie me qira ose vënien e hipotekave që mund të konsiderohet i dobishëm ose i domosdoshëm për realizimin e qëllimeve të Shoqërisë;
- (b) të fitojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, interesa në shoqëri të tjera të cilat kanë një objekt të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri ose jashtë saj; dhe
- (c) të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm ose i domosdoshëm për realizimin e qëllimeve të Shoqërisë.

4.3 Për më tepër, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili nuk është i ndaluar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali i nënshkruar dhe tërësisht i paguar i Shoqërisë është 370,000,000 (Treqind e shtatëdhjetë milion) lekë i cili përbëhet nga 370,000 (treqind e shtatëdhjetë mijë) aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej 1,000 (një mijë) lekë secili. Kapitali është nënshkruar dhe paguar si më poshtë:

- Shoqëria Albsig sh.a, zotëron 370,000 (treqind e shtatëdhjetë mijë) aksione të cilat përbëjnë 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 6

Aksionet

Aksionet e Shoqërisë mund të transferohen sipas procedurave të parashikuara në Nenin 7 të Statutit.

Neni 7

Përbërja dhe Emërimi i Këshillit Mbikëqyrës

7.1 Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 3 anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme për një afat tre (3) vjeçar dhe mund të rizgjidhen.

7.2 Këshilli Mbikëqyrës emëron midis anëtarëve të tij, Kryetarin dhe Nënkryetarin me votën pro të shumicës së anëtarëve të tij.

7.3 Anëtarët e parë të Këshillit Mbikëqyrës emërohen personat e mëposhtëm:

Plarent Hamzaj

Redi Ujkashi

Klodian Gjonaj



Neni 8
Adminstratori

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme emëron Administratorin e Shoqërisë, i cili do të jetë përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë sipas kufizimeve të parashikuara nga ligji në fuqi dhe Statuti.
- 8.2 Administratori emërohet për një afat tre (3) vjeçar dhe mund të rizgjidhet.
- 8.3 Emërohet administrator si Administrator i Shoqërisë personi i mëposhtëm:
Ervin Spahiu

Neni 9
Kontrollorët

- 9.1 Auditimi i brendshëm i Shoqërisë kryhet nga një ose më shumë ekspertë kontabël të autorizuar të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme për një vit financiar.
- 9.2 Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi:
▪ ekspert kontabël i autorizuar emërohet: Mazars Albania sh.p.k.



Neni 10
Dispozitë Përfundimtare

Për ç'farë nuk parashikohet në këtë Akt Themelimi, do të zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi për Shoqëritë Tregtare.

Palët deklarojnë se ky Akt Themelimi është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre, dhe e nënshkruajnë atë në praninë time, Noterit, në datën e sotme, me vullnetin e tyre të plotë e të lirë, dhe unë Noteri vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

AKSIONARI I VETËM
SHOQËRIA ALBSIG SH.A.

Z. MUHARREM BARDHOCI
Përfaqësues i aksionarit të vetëm



NOTER
SOKOL SH. MALAJ



NOTER. SOKOL SH. MALAJ
RR"LUIGJ GURAKUQI" P 2 TIRANË, ALBANIA
Tel: +355 4 222 98 32 / Cel: +355 68 40 5555 4
e-mail: kollimalaj@hotmail.de

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEGA VENDORE E NOTERISË TIRANË
NR.— 1514 —REP
NR.— _____ —KOL



VËRTETIM NOTERIAL

Sot më datë 02.08.2019 (dy mijë e nëntëmbëdhjetë), ditën e Premte, përpara meje noterit SOKOL SH. MALAJ, anëtar i Dhomës Kombëtare të Noterëve, Dega Tiranë, me adresë Rruga “Luigj Gurakuqi”, Pallat i ri, u paraqit personalisht :

Z.MUHARREM BARDHOCI i biri i Riza dhe Kadime, lindur në Mamëz, Kukës, më 07.07.1960, banues në Tiranë, Rr. “A.Lenja” Nr 7, i identifikuar me Kartën e Idenditetit #030236066# me Nr personal #G00707039R# aktualisht përdorues i telefonit 00355692045124 **Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë e sigurimeve “ALBSIG” SHA**, regjistruar si Person Juridik, me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me Nr. 30756, datë 09.01.2004, i pajisur me NIPT **K42108801C**, me seli në Rr. “Barrikadave”, Tiranë, njëkohësisht edhe si përfaqësues ligjor i Shoqërisë Albsig sh.a, sipas vendimit të përfaqësimit të lëshuar nga Asambleja e Aksionerëve të Albsig sh.a Vendim01/3 të datës 27/06/2019.—

I lartpërmenduri është madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar; i cili pasi u sqarua për pasojat Juridike që sjell ky Akt, deklaroi nën përgjegjësinë e tij ligjore se sa më sipër është një akt, Vendim i hartuar me vullnetin e tij të lirë e të plotë jashtë kësaj zyre dhe i nënshkruar prej tij më datë 02.08.2019.—

Unë Noteri pasi konstatova se ai akt nuk vjen në kundërshtim me ligjin dhe interesat e kërkuesve u nënshkrua në praninë time dhe unë Noteri e vërtetoj atë sipas ligjit.—

Për të vërtetuar sa më sipër u hartua ky akt noterial i cili si u lexua dhe u gjet sipas vullnetit të porositësve u nënshkrua në praninë time, sipas ligjit dhe unë Noteri e vërtetoj atë rregullisht.—

**AKSA E PULLËS
U.PAGUA**

**NOTER
SOKOL SH. MALAJ**

NOTER. SOKOL SH. MALAJ
RR“LUIGJ GURAKUQI” P 2 TIRANË, ALBANIA
Tel: +355 4 222 98 32 / Cel: +355 68 40 5555 4
e-mail: kolimalaj@hotmail.de